



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 29 maj 2018
Nr. ref.: RK 1237/18

VENDIM PËR REFUZIM TË KËRKESËS

në

rastin nr. KI08/18

Parashtrues

Naser Berisha

Kërkesë për rishikimin e pretendimeve të ngritura në Aktvendimin për papranueshmëri të Gjykatës Kushtetuese, të 14 nëntorit 2017, në rastin KI104/17

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërzhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Naser Berisha, me vendbanim në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktvendimin për papranueshmëri të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata), të 14 nëntorit 2017, në rastin KI104/17, me të cilin është shpallur kërkesa e tij si qartazi e pabazuar.

Objekti i çështjes

3. Objekti i çështjes së kësaj kërkesë në të vërtetë ka të bëjë me kërkesën e parashtruesit për rishikimin e pretendimeve të tij të ngritura në kërkesën e mëparshme KI104/17.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës], 47 [Kërkesa individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji).

Procedura në Gjykatë

5. Më 15 janar 2018, parashtruesi i kërkesës dorëzoi kërkesën në Gjykatë.
6. Më 16 janar 2018, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Altay Suroy gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Arta Rama-Hajrizi (kryesuese), Bekim Sejdiu dhe Gresa Caka-Nimani.
7. Më 23 janar 2018, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës.
8. Më 19 prill 2018, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës, ta refuzoi kërkesën me procedurë të shkurtër.

Përmbledhja e fakteve

9. Më 14 shkurt 2007, parashtruesi i kërkesës parashtrroi padi kundër R. C. dhe Ndërmarrjes Shoqërore KBI “Kosova Export”, komuna e Fushë-Kosovës për rikthimin e disa parcelave të tokës të cilat parashtruesi pretendonte se i ishin konfiskuar Z. Z., paraardhësit të babait të tij. Më 6 shkurt 2009, Gjykata Themelore në Prishtinë, përmes Aktvendimit C. nr. 231/2007, e shpalli veten jokompetente për të vendosur rastin dhe padia iu dërgua Kolegjit të Specializuar të Dhomës së Posaçme për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i cili më 12 prill 2011, refuzoi kërkesëpadinë, sa i përket paditëses R. C., si të papranueshme.
10. Më 26 prill 2011, Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP), si përfaqësuese e ndërmarrjes shoqërore, parashtrroi kërkesë për pezullimin e procedurës në këtë lëndë pasi ndërmarrja shoqërore ishte duke ju nënshtruar procedurës së likuidimit. Më 21 nëntor 2011, Kolegji i Specializuar përmes Aktvendimit nr. SCC-09-0217, refuzoi kërkesën e AKP-së për pezullimin e procedurës në lidhje me padinë e parashtruesit. Më 18 dhjetor 2014, Kolegji i Apelit (Aktvendimi

ASC-11-0108), refuzoi si të pabazuar ankesën e AKP-së kundër Aktvendimit (nr. SCC-09-2017) të Kolegjit të Specializuar.

11. Më 26 tetor 2015, Kolegji i Specializuar (Aktvendimi nr. SCC-09-0217) hodhi poshtë padinë e parashtruesit si të papranueshme “*pasi paditësi nuk ka arritur ta sigurojnë aktvendimin mbi trashëgiminë e trashëgimtarëve të Z. Z.*” për të vërtetuar legjitimitetin e tyre aktiv në rastin konkret. Më 24 nëntor 2015, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë kundër Aktvendimit të Kolegjit të Specializuar (SCC-09-0217) në Kolegjin e Apelit “*për shkak të shkeljes së të drejtës materiale*”. Më 6 prill 2017, Kolegji i Apelit (Aktvendimi nr. AC-I-15-0265), refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit, duke vërtetuar Aktvendimin e Kolegjit të Specializuar.
12. Më 25 gusht 2017, parashtruesi në Gjykatë dorëzoi kërkesën KI104/17, përmes së cilës kërkoi rishikimin e kushtetutshmërisë së Aktvendimit [AC-I-15-0265, të 6 prillit 2017] të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Parashtruesi i kërkesës pretendonte shkeljen e të drejtave të tij të garantuara me nenet 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës, si dhe nenin 1 [Mbrojtja e Pronës] të Protokollit nr. 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.
13. Më 14 nëntor 2017, Gjykata pasi vlerësoi pretendimet e parashtruesit të kërkesës erdhi në përfundim se kërkesa e parashtruesit, duhej shpallur e papranueshme, si qartazi e pabazuar, në baza kushtetuese, duke arsyetuar:

“Se parashtruesi i kërkesës nuk ka paraqitur dëshmi, fakte dhe argumente që tregojnë se procedurat para Kolegjit të Apelit kanë paraqitur në ndonjë mënyrë shkelje kushtetuese të të drejtave të tij të garantuara me Kushtetutë, përkatësisht të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm dhe të drejtës për mbrojtjen e pronës. Rrjedhimisht, Gjykata ujen në përfundim se kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe duhet të deklarohet e papranueshme, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 48 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) (d) dhe (2) (d) të Rregullores së punës.”

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

14. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata, duke shpallur kërkesën e mëparshme të tij KI104/17 të papranueshme, si qartazi të pabazuar, “vërtetoi shkeljet” që i janë shkaktuar atij me vendimet e gjykatave të rregullta, duke pretenduar se refuzimi i kërkesës së tij nga Gjykata është në kundërshtim me të drejtën “*për një gjykim të paanshëm, sipas përcaktimit të nenit 6 të KEDNj-së (Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut)*”.
15. Në fund, parashtruesi përsëriti pretendimet e tij siç i kishte ngritur në kërkesën KI104/17, duke kërkuar nga Gjykata që ta njohë atë si trashëgimtar të paraardhësit të tij, dhe që paraardhësi i tij të njihet si pronar legjitim i disa paluajtshmërive (parcelave) të konfiskuara nga regjimi i atëhershëm i para viteve të 90-ta (nëntëdhjeta), duke pretenduar se ato i janë marrë familjes së tij

në shfrytëzim, sipas një plani rregullativ të parcelave (komasacionit) në disa zona të ndryshme kadastrale.

Pranueshmëria e kërkesës

16. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
17. Përkitazi me këtë, Gjykata i referohet rregullit 32 (5) të Rregullores së punës, që përcakton:

“Gjykata mund të refuzojë një kërkesë me procedurë të shkurtër, ... nëse kërkesa është përsëritje e një kërkesë të mëparshme të vendosur nga Gjykata ose ...”.
18. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës, në të vërtetë, përmes kërkesës së tanishme kërkon nga Gjykata që t'i marrë sërish në konsideratë pretendimet e tij të ngritura në kërkesën e mëparshme KI104/17.
19. Gjykata në kërkesën e mëparshme KI104/17 të parashtruesit të kërkesës i trajtoi të gjitha pretendimet e ngritura nga ai, duke iu përgjigjur veç e veç secilit prej tyre dhe erdhi në përfundim se kërkesa duhej deklaruar qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, dhe rrjedhimisht të papranueshme, nga arsyet e përmendura në paragrafin 13 të këtij vendimi.
20. Në këtë drejtim, Gjykata konsideron se kërkesa e tanishme nuk paraqet ndonjë rrethanë të re për t'u rikonsideruar nga Gjykata. Për të gjitha çështjet e ngritura në këtë kërkesë, Gjykata tashmë ka vendosur në rastin KI104/17.
21. Andaj, Gjykata konsideron se kërkesa e tanishme nuk paraqet asnjë provë a rrethanë të re për t'i rishikuar pretendimet e parashtruesit të ngritura në kërkesën e mëparshme KI104/17, për të cilat Gjykata vendosi me Aktvendim për papranueshmëri, më 14 nëntor 2017 (shih, ngjashëm me këtë situatë, Vendimin për refuzim të kërkesës të Gjykatës Kushtetuese në rastin KI26/14, me parashtrues *Bajrush Gashi*, të 26 marsit 2015, paragrafi 24).
22. Gjykata, rikujton se, ankimi individual sipas kuptimit të nenit 113.7 të Kushtetutës, nuk duhet të shikohet nga parashtruesit e kërkesës si mundësi për të kërkuar në mënyrë të përsëritshme nga Gjykata rishikimin e vendimeve apo rihapjen e vendimeve për çështjet për të cilat Gjykata ka vendosur njëherë.
23. Për më tepër, Gjykata rikujton se vendimet e saj janë vendime të formës së prerë dhe të detyrueshme për gjyqësorin, për të gjithë personat dhe për të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës (shih, ndër të tjera, Vendimin e Gjykatës Kushtetuese, në rastin KI26/14, parashtrues *Bajrush Gashi*, të 26 marsit 2015, paragrafi 26 dhe 27).
24. Si përfundim, Gjykata konsideron se kërkesa e tanishme e parashtruesit të kërkesës, në fakt, është përsëritje e një kërkesë të mëparshme të vendosur nga

Gjykata. Prandaj, në pajtim me rregullin 32 (5) të Rregullores, kjo kërkesë duhet të refuzohet me procedurë të shkurtër.

PËR KËTO ARSYE


Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 113.7 të Kushtetutës, të nenit 20 të Ligjit dhe rregullit 32 (5) të Rregullores së punës, më 19 prill 2018, njëzëri

VENDOS

- I. TA REFUZOJË kërkesën me procedurë të shkurtër;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Altay Suroy



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi